

HAPEN DOKTORATURAT NË UNIVERSITETIN BUJQËSOR TË TIRANËS

Në bashkëpunim me Qeverinë Gjermane, në Universitetin Bujqësor të Tiranës ka nisur programi i doktoraturës në Bujqësi, Mjedis, Bioteknologji, Agrobiznes dhe Mjekësi Veterinare, i cili synon kualifikimin e mëtijshëm të studentëve ekselentë dhe profesionistëve të rinj, duke shfrytëzuar ekselencën e Bashkimit Evropian.

Ministrja Kushi ka nënvizuar se MAS do jetë shumë rigorozë, dhe pret që edhe universitetet të jenë njësoj rigorozë në respektimin pikë për pikë të të gjitha atyre kritereve, të hartuara e miratuara së bashku. Për ta garantuar këtë, vëmendja duhet të jetë maksimale te cilësia.



BIBLIOTEKAT E 113 SHKOLLAVE PASUROHEN ME TITUJ TË RINJ

Bibliotekat e 113 shkollave në të gjithë Shqipërinë këtë fillimvit kanë nisur të pasurohen me tituj të rinj, literaturë shkencore didaktike dhe literaturë artistike.

Procesi i shpërndarjes vjen pas një pune të gjatë të bordeve të pavarura të ngritura nga MAS dhe investimi do të vazhdojë çdo vit.



PROJEKTI "EKIPET SPORTIVE NË SHKOLLA DHE UNIVERSITETE"

Për herë të parë qeveria shqiptare ka akorduar një fond prej 5 milionë eurosh për masivizimin e sportit në shkolla e universitete, për krijimin e ekipeve sportive, për organizimin e kampionateve në nivel shkolle, në nivel universiteti, bashkie, qarku dhe në nivel kombëtar.



ZGJERIMI DHE FUQIZIMI I VLERËSUESVE TË JASHTËM

Nisi procesi i trajnimit për 100 pjesëmarrësit e parë në programin për zgjerimin dhe fuqizimin e rrjetit të vlerësuesve të jashtëm. Brenda 2 vitesh do të certifikojmë 400 vlerësues, duke rritur kështu kapacitetet dhe duke iu afruar më shumë referencave evropiane të periodicitetit të vlerësimit të institucioneve arsimore.



VKM E RE PËR SIGURINË NË SPORT

Në mbledhjen e qeverisë të datës 26 janar, u miratua vendimi për masat e sigurisë në sport, veçanërisht në futboll. Në ligjin për sportin është parashikuar qartë që dhuna kërcënon integritetin e sportit. Ky është një përmirësim i nevojshme i kuadrit nënligjor. Me këtë vendim janë parashikuar përgjegjësitë, hapat dhe penalitetet që duhet të ndërmerren.

SHQIPËRIA MERR PJESË NË LOJËRAT OLIMPIKE "PEKIN 2022"

Ministrja e Arsimit dhe Sportit Evis Kushi i dorëzoi flamurin kombëtar sportistit Denni Xhepa dhe delegacionit zyrtar të Shqipërisë që do të marrë pjesë në Lojërat Olimpikë "Pekin 2022".